

Rekomandime për Ministrinë e Financave

Impakti i ankimimeve të vendimeve të Drejtorisë së Apelit të Tatimor (DAT) në gjykate dhe menyrat për të përmirësuar klimën e biznesit në këto drejtim.

Shoqata “Bashkimi Tregtar i Shqiperisë”, si përfaqësuese e interesave të aktivitetit të distributoreve dhe shitësve me pakice në Shqipëri, paraqet shqetësimet dhe sugjerimet e saj si vijojnë:

1. Problematikat:

Aktualisht, në përputhje me Ligjin e Procedurave dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, në momentin kur DRT nxjerr një Njoftim Vlerësimi (“**NJV**”) ndaj një tatimpaguesi, në sistemin kompjuterik të DRT, pasqyrohet detyrimi tatimor që NJV ka nxjerre. Ky detyrim qëndron i tillë derisa të jete paguar, apo derisa një vendim përfundimtar të jete marrë dhe DRT vendos ta reflektojë atë në sistemin kompjuterik.

Në mënyrë që një ankim i tatimpaguesit të merret në konsideratë dhe të shqyrtohet, duhet që tatimpaguesi, të parapaguajë apo të japë një garanci bankare në favor të DRT shumen e principalit të parashikuar në NJV. Garancia bankare apo/dhe paragimi qëndrojnë në favor të DRT deri në momentin kur është vendosur heqja nga sistemi tatimor të detyrimit të pasqyruar në NJV.

Edhe pse duhet theksuar se krijimi i mundësisë së dhënies së një garancie bankare, si alternative e parapageses, ka qenë një hap shumë i rëndësishëm përpara në ndihmë të bizneseve, po ashtu duhet theksuar se kostoja që ka biznesi (direkte dhe indirekte) edhe në rastin e garancisë bankare mbetet tejet e lartë dhe me pasoje direkte në zhvillimin e tij (biznesit).

Mjafton të përmendim se garancia bankare në këto rast mund të leshohet nga banka vetëm kundrejt koston dhe vetëm nëse tatimpaguesi (i) bllokoi likuiditetin sa është dhe vlera e garancisë bankare, ose (ii) përdori një instrument financiar garantues nga banka, e cila në fund të ditës është e barazvlefshme me kredinë bankare si nga kosto (interesi etj) ashtu edhe për nga kolaterali që duhet të japë biznesi. Në të dyja rastet, biznesi i duhet që përveç kostove direkte që ka për këto lloje instrumente, të bllokojë likuiditetin (në shumën e pasqyruar në NJV) apo/dhe të krijojë një ekspozim bankar në favor të DRT, çka e kufizon biznesin që një instrument i tillë ta përdorë për investime apo rritje të tij, derisa DRT të vendosë për heqjen nga sistemi kompjuterik i saj të detyrimit të tatimpaguesit.

Nderkohe që periudha minimale dhe maksimale deri në zgjidhjen përfundimtare të procesit të ankimit shkon mesatarisht nga 3 deri në 6 vite.

Në shtesë të kësaj, tatimpaguesit i duhet që të vazhdojë të paguajë çdo muaj detyrimet tatimore që krijohen si pasoje e aktivitetit të tij.

Situata e pershkruar me siper, krijon nje trysni te madhe ndaj biznesit duke e vendosur ate ne nje pozite thellesisht te pabarabarte me administraten tatimore. Keshtu ndersa gjate gjithe kohes qe zhvillohet procesi i ankimit, qe nga ankimi ne DAT deri ne perfundim te gjykimit ne Gjykatën e Lartë, tatimpaguesi ka parapaguar detyrimin/principalin apo ka bllokuar dhe/ose ka marre kredi ne ate shume ne banke per te dhene garanci bankare, DRT nuk ka nje presion te tille dhe per rrjedhoje jo ne pak raste procesi zgjatet dhe ne menyre artificiale, duke shpresuar ne nje terheqje te tatimpaguesit.

Ne te kaluaren, pikerisht prej ketij mekanizmi, mund te themi qe eshte nxitur edhe korrupsioni ne admisnitraten tatimore, pasi tatimpaguesit detyroheshin qe te gjenin menyra *extraligjore* per te rene dakord me admisnitraten tatimore, pikerisht per shkak te kostos shume te larte dhe zgjatjes se procesit te ankimit, edhe ne rastet kur ata kishin te drejte.

Keshtu permiresimi (ne kohe) qe solli shqyrtimi i ceshtjeve administrative ne gjykatën e shkalles se pare dhe ate te apelit admisnitrative, thujse zhvleresohet nga koha shume e gjate e pritjes per tu shqyrtuar ne Gjykatën e Lartë. (Ketu nuk po marrim fare ne konsiderate kostot e perfaqesimit ligjor ne gjykate nga tatimpaguesi, qe ne cdo rast jane ne perpjestim te drejte me shkallen gjyqesore ku ndodh ky perfaqesim).

Edhe pse jo aq e rendesishme, mendojme qe nje sistem i tille, ka krijuar problematike edhe per vete administraten tatimore pasi ne menyre thujse artificiale ka rritur debine e kesaj administrate ndaj tatimpaguesve gjate periudhes se perfundimit te shqyrtimit gjyqesor te ceshtjes. Pa permendur ketu kostot financiare qe i eshte dashur te paguaje ne rastet kur e ka humbur konfliktin gjyqesor.

Situata behet e akoma me e komplikuar per te dy palet (DRT dhe tatimpaguesin), vecanerisht duke pasur parasysh detyrimin e DRT per te ndjekur ne te gjitha shkallet e gjyqesorit nje konflikt gjyqesor ku ajo eshte pjese, ne perputhje me Udhezimin e Ministrisë së Financave.

Ndonëse Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj Nr. 39 date 30/06/2014, e ka gjetur jo ne kundërshtim me Kushtetuten te drejten e DRT per te bere ankim ne gjykate ndaj vendimeve te DAT, mendojmë se ka ardhur koha që të shikohet mundësia për të gjetur alternativa që adresojnë shqetësimet e bizneseve pa cënuar te drejten e DRT's për të mbledhur detyrimet tatimore. Kjo mund të bëhet duke i vënë detyrimin DRT's që të ktheje/çlirojë garancinë bankare në momentin që DAT ka vendosur kundra vendimit të DRT, ose duke e specifikuar më qartë në udhëzime përkatëse rastet kur DRT mund të mos bëjë rekurs në Gjykatën e Lartë pasi është marrë një vendim i formës së prerë.

2. Sugjerimet

- i) Sipas mendimit tone, nje shtyse jo e vogel e DRT per te bere ankim ne gjykate ndaj vendimit te DAT, eshte pozita teresisht e pabarabarte e paleve gjate procesit. Ndersa tatimpaguesi (sic u tha me lart) ka nje kosto te larte per te bere ankimin, por me teper per

ta perfunduar ate ne te gjitha shkallet, DRT, nuk ka te tilla kosto dhe presioni mbi të është minimal.

Nese legjislacioni do te parashikonte detyrimin qe pas perfundimit te apelit nga DAT dhe te nje vendimi ne favor te tatimpaguesit, ketij te fundit i kthehen shumat e parapaguara dhe/pse garancia bankare e dhene, atehere, mendojme se DRT do te ishte perballe nje zgjedhje te kujdesshme te vendimeve te DAT qe do te apelonte ne gjykate. Po keshtu ky mekanizem nuk do te kishte kosto per DRT edhe ne rast te humbjes se procesit ne gjykate, pasi tatimpaguesi do ti kishte terhequr parate dhe nuk do te kerkonte interesat/kamate vonesat per periudhen qe i kishjte pasur te bllokuara.

Sigurisht, kjo gjithashtu do të sillte çlirimin e bizneseve nga kostot e shumta që shoqërohen si me bllokimin e garancisë bankare përgjatë proceseve të përzgjedura gjyqësore. Pëveç kësaj, kjo gjithashtu do të ulte kostot që kanë bizneset për të përballuar këto procese, duke qenë se DRT do ishte më e kujdesshme dhe përzgjedhëse në vendimarrjen për ta çuar ose jo një çështje në proces gjyqësor.

- ii) Në shtesë të sa më lart është shume e llogjikshme dhe teresisht e mundshme, madje dhe e bazuar në legjislacionin aktual, që DRT të ketë discrecionin që të vlerësojë nëse duhet apo jo të bëjë rekurs në Gjykatën e Lartë ne rastet kur ka nje vendim te formes se prere te Gjykates se Apelit Administrativ ne favor te tatimpaguesit.

Megjithë pavaresise ne vendimmarrje, DAT mbetet nje organ i ekzekutivit. Nese, pas ankimit qe DRT ben ndaj vendimi te ketij organi ne gjykate dhe, ndjekjes se ceshtjes ne gjykatën e shkalles se pare dhe te apelit (administrativ), perseri kjo e fundit i ka dhene te drejte tatimpaguesit, ndjekja e procesit edhe ne Gjykatën e Lartë edhe ne rastet kur vete DRT eshte e bindur per mungesen e eficences te ketij procesi do te ishte me kosto te larte per te dy palet.

Per kete arsye, ne perputhje me Udhezimin e MF dhe ne linje me parashikimet e pikes 109.7, 109.10, Ministria e Financave, mund te parashikojë procedura sipas te cilave, ne rastet kur (i) DAT ka vendosur te shfuqizojë teresisht apo pjeserisht nje detyrim tatimor te pasqyruar ne nje NjV te DRT dhe (ii) kjo e fundit ka ankimuar gjyqesisht vendimin e DAT, (iii) DRT ka te drejte qe me miratimin e Drejtorise se Perjgithshme te Tatimeve, te vendose te mos beje rekurs ne Gjykatën e Lartë ndaj nje vendimi te Gjykates se Apelit Administrativ qe ka vendosur ndaj ankimit te saj (DRT).

Mendojme qe nje zgjidhje e tille, (i) siguron mbrojtjen e interesave te DRT, (ii) realizon shqyrtimin gjyqësor dhe me te kualifikuar te vendimit te DAT, (iii) shkurton kostot si per DRT ashtu dhe per tatimpaguesin.

Përveç sa më lart, mendojmë se me këtë ndërhyrje Ministria e Financave mund të përcaktojë standardet dhe procedurat në bazë të të cilave DRT mund të vendosë të mos bëjë rekurs pranë Gjykatës së Lartë për një çështje e cila në bazë të Ligjit të Procedurave tatimpaguesi ka të drejtën të apelojë direkt në gjykatë pa kaluar ne procesin e apelimit

administrativ. Kështu, ka raste në të cilat Gjykata e Apelit me vendim të formës së prerë e ka zgjidhur një konflikt ndërmjet tatimpaguesit dhe DRT-së. Në këto raste, duke pasur parasysh dhe kostot shumë të larta jo vetëm për tatimpaguesin por edhe për vetë DRT nga zgjatja e procesit, mendojmë se DRT duhet të ketë tagrin që të vendosë të mos bëjë rekurs në Gjykatë të Lartë në rast se e gjykon çështjen pa mundësi për tu fituar, pasi të ketë marrë aprovimet përkatëse nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

3. Konkluzion

Në përfundim mund të themi se edhe pse ka një permiresim të ndjeshëm të kostove dhe mundësive të tatimpaguesve për të ankimuar ndaj vendimeve të DRT, sistemi aktual dhe vecanerisht kërkesa për të (i) pasur garanci bankare apo parapaguar principalin e detyrimit tatimor të pasqyruar në NjV deri kur kemi një vendim përfundimtar gjyqësor (pasi është prehur Gjykata e Lartë) si dhe (ii) praktika e DRT për të ankimuar çdo vendim të DAT që nuk lehtëson vendimin e saj (DRT) në të gjitha shkallët e procesit gjyqësor, përfshi Gjykatën e Lartë, rezultojnë në një pabarazi të dukshme të paleve në proces si dhe në kosto të larta si për DRT ashtu dhe për tatimpaguesin.

Kthimi i parapageses apo garancise bankare në rast të apelit të vendimit të DAT nga DRT në gjykatë si dhe përcaktimi i procedurave dhe standardeve kur DRT ka të drejtë që të mos bejë rekurs në Gjykatën e Lartë, atëherë kur DRT e gjykon të panevojshëm rekursin, do të ishin inisiativa që do të sillnin permiresime në gjendjen aktuale.

Baza Ligjore: (i) Ligji i Procedurave Tatimore; (ii) Udhezimin Nr. 4, datë 27.01.2011 "Per Zbatimin e Buxhetit të vitit 2011" (në vijim "Udhezimi i MF"; (iii) Vendimin Nr. 39 datë 30/06/2014 të Gjykatës Kushtetuese (në vijim "Vendimi i GJK"), Udhezim Nr. 24 datë 02/09/2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar (në vijim "Udhezimi i procedurave"), Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. 16 datë 25.07.2008;

Me respekt,

Shoqata "Bashkimi Tregtar i Shqipërisë"